



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	ÇIKIŞ - Dalëse - Izlazna - Outgoing 02 No.Nr. 137-25 Tarih/Dt. 25.07.2025
---	--

Referenca: 626-24-5207-1-2-1

Me 25.07.2025

M a m u s h ë

Në bazë të Nenit 62 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Rregullores Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik neni 43 Paragrafi 43.5 pika (b) si udhëheqës i sektorit të Prokurimit bie këtë:

V E N D I M

I

Anulohet aktiviteti i prokurimit me nr. 626-24-5207-1-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-24-008-1-2-1

II

Tenderi të rishpallet pas afatit ligjor për parashtrimin e ankesave eventuale.

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Mamushës, me datë 31.05.2024 ka shpallur njoftimin për kontratë me titull: "Furnizimi me material shpenzues për laborator dhe material shpenzues dentar" me nr. të prokurimit 626-24-5207-1-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-24-008-1-2-1. Pas njoftimit për kontratë, dosjen e tenderit e kanë shkarkuar nëntëmbëdhjetë (19) Operator Ekonomik, ndërsa tenderin e kanë dorëzuar vetëm tre (3) prej tyre. Fillimisht Në mesin e tenderuesve dy (2) operator ekonomik kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm, ndërsa një (1) prej tyre ka dorëzua tender të pa përgjegjshëm. Pas vendimit të parë të dytë dhe të tretë për anulim të kësaj procedure, operatori ekonomik Medplus SHPK ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim. Pas refuzimit të kërkesave i njëjti ka paraqitur ankesë në OSHP. Pasi është shqyrtuar ankesa me vendim të OSHP-s, është kthyer lënda në rivlerësim. Gjatë procedurës së rivlerësimit është konstatuar që asnjëri nga O.E. pjesëmarrës nuk ka qenë i përgjegjshëm. Andaj edhe nga komisioni i rivlerësimit për të tretën herë rekomandohet që kjo procedurë e prokurimit të anulohet.

Andaj duke u bazuar në atë që u tha më lartë, në dispozitat e nenit 62 të LPP-s si dhe nenit 43 paragrafi 43.5 pika (b) të Rregullores Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gazmend Gashi

Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës

